



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:229107

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05715740

P.nr.569/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit I. Z., për shkak të veprës penale “Rrezikimi i trafikut publik” nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.5781/23, të datës 30.11.2023, pas përfundimit të seancës së hapur të të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 20.05.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Nazmi Krasniqi, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit av. R. P., me datë 21.05.2024 mori dhe publikisht shpalli dhe të njëjtën ditë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

I. Z., nga i ati R. dhe nëna H., mbiemri i vajzërisë së nënës S., i lindur më ... në fshatin B., ndërsa me vendbanim në fshatin B., Komuna P., me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën e lartë teknike të makinerisë, pensionist, i ve, baba i gjashtë (6) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

I. Me datë 16.08.2023, rreth orës 12:30, në magjistralen P. – P., saktësisht tek kthesa në dalje të fshatit L. i P. afër shtëpive të H. P., derisa ishte duke drejtuar automjetin e tipit “O. C.” me targa ... , nga pakujdesia vepron në kundërshtim me dispozitën e nenit 41, 53, 68 dhe 72 të Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, dhe me këtë shkakton aksident trafiku, duke vënë në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që i pandehuri nga pakujdesia duke mos përshtat rregullat e përgjithshme të trafikut, si shpejtësinë e lëvizjes me kushtet e rrugës, në vendin ku shpejtësia e lejuar është e kufizuar në 40 km/h ka zhvilluar shpejtësi prej 69 km/h, pastaj në vendin ku drejtimiet jaë të ndara me vijë të plotë (ndalim tejkalmi) ka hyrë në tejkalm të automjeteve që kishte përpara tij dhe në pamundësi për t’i tejkalmuar i gjendur në shiriti e kahjes së kundërt, me pjesën e përparme ballore të automjetit, e godet frontalisht automjetin tjetër I. me targa ... , me ç’rast palës së dëmtuar pasagjerit N. F. i shkakton lëndime të rënda trupore, ndrydhje të indeve

të buta të anës së majtë të kraharorit, thyerje e brinjës VII dhe VIII të anës së majtë të kraharorit të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë dhe të furishëm, si pasojë e aksidentit në trafik e që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore të konstatuara me akt ekspertimin mjeko ligjor i datës 25.10.2023.

- me këtë ka kryer veprën penale “Rrezikimi i trafikut publik” nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të dispozitave ligjore si më lartë dhe neneve 4, 7, 17, 23, 38, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe 79 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 367, 449 dhe 462 par. 2 të KPP-së, të pandehurin e:

GJYKON ME DENIM ME KUSHT

I. Ashtu i vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën e verifikimit prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale.

V. DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale për ekspertizë mjeko ligjore të paguajë shumën prej katërdhjetë (40) Euro, për ekspertizë të aksidentit në komunikacion shumën njëqind e pesëdhjetë (150) Euro, për paushallin gjyqësor shumën prej njëzet (20) Euro dhe në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit po ashtu shumën prej njëzet (20) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

VI. Të dëmtuarit N. F., M. F. dhe H. A., që të tre me adresë banimi në fshatin T. – Komuna P., për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest të rregull juridiko - civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.5781/23, të datës 30.11.2023, kundër të pandehurit I. Z., për shkak të veprës penale “Rrezikimi i trafikut publik” nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 20.05.2024, në të cilën pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi bindet se i pandehuri e kupton aktakuzën, në kuptim të nenit 241 par. 4 të KPP-së, të njëjtit i ka ofruar mundësinë e deklaramit rreth fajësisë - të pranojë fajësinë për veprat penale për të cilat është akuzuar apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar, pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, duke shprehur keqardhje dhe pendesë të thellë për ngjarjen e ndodhur, të dëmtuarve dhe familjeve të tyre u ka kërkuar falje për dëmin e shkaktuar, nga gjykata kërkoi që të refuzojë propozimin e prokurorit të shtetit për shqiptimin e dënimit plotësues “Ndalimi i drejtimit të automjetit për kategorinë B1 dhe B”, ngase sipas tij jeton i vetëm dhe një masë e tillë do t’i pamundësonte kryerjen e shërbimeve esenciale, po ashtu i njëjti ka kërkuar që gjykata t’i shqiptoj një sanksion më të butë penal.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj gjatë marrjes në konsideratë të pranimi të fajësisë nga i pandehuri, mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ngase pranimi i fajësisë gjen mbështetje në provat që gjenden në aktakuzë, gjykatës i propozoi që ta aprovojë pranimin e fajësisë, të pandehurin ta shpallë fajtor dhe dënojë sipas ligjit, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, ka propozuar që si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata të ketë parasysh shkallën e lartë të pjesëmarrjes në kryerjen e veprës penale, ndërsa si rrethana lehtësuese të ketë parasysh moshën e shtyer, pranimin e fajësisë gjatë gjithë fazave të procedurës, keqardhjen e shfaqur. Mbetet në tërësi pranë propozimit që të njëjtit gjykata t'i shqiptojë dënimin plotësues “Ndalimi i drejtimit të automjetit të kategorisë B1 dhe B”.

Mbrojtësi i të pandehurit I. Z. av. R. P. ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, ngase i mbrojturi i tij vullnetarisht ka pranuar fajësinë pas konsultimit të mjaftueshëm me të si mbrojtës, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, nga gjykata ka kërkuar që si rrethana lehtësuese për të mbrojturin e tij të ketë parasysh faktin se i njëjti në të gjitha fazat e procedurës ka pranuar fajësinë, me të dëmtuarit i ka rregulluar raportet sipas së drejtës zakonore, është hera e parë që ka rënë në kundërshtim me ligjin për rregullimin e trafikut rrugor, është i moshuar, jeton i vetëm, shqiptimi i dënimit plotësues i propozuar nga prokurori i shtetit, për shkak se i njëjti jeton në fshat, zonë rurale, do të kishte me ndikuar negativisht tek i njëjti dhe do ta privonte atë nga përmbushja e nevojave elementare si blerja e ushqimit, barnave, vizitave mjekësore, si dhe shërbimeve tjera.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimi të fajësisë nga i pandehuri si dhe marrjes në konsideratë të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurit të ndërmarra nga pakujdesia, manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprave penale “Rrezikimi i trafikut publik” nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që në rastin konkret si rrethana lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen e shfaqur, premtimin se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit dhe nuk do të përsëris veprën penale, kërkim falje të dëmtuarve, i moshuar, ndërsa si rrethana rënduese nuk gjeti, andaj nga arsyet dhe rrethanat e sipër theksuara ka ardhur në përfundim se dënimin me kusht si dënim alternativ i shqiptuar të pandehurit, është adekuat dhe në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij, me bindje se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht i paraparë me nenin 47 të KPRK-së, i cili konsiston në risocializimin e të pandehurit me anë të pezullimit të dënimit, me të cilin dënim të pandehurit seriozisht i tërhiqet vërejtja dhe i bëhet me dije se nëse i njëjti kryen

vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit, gjykata do të revokojë dënimin me kusht dhe do të urdhërojë ekzekutimin e dënimit të caktuar në dënimin me kusht.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka refuzuar propozimin e prokurorit të shtetit që ndaj të pandehurit krahas sanksionit penal të shqiptoj edhe dënimin plotësues “Ndalimi i drejtimit të automjetit të kategorisë B1 dhe B” ngase marrë parasysh rrethanat e rastit konkret, faktin se i pandehuri është i moshuar dhe nga evidenca penale nuk rezulton të ketë qenë më parë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale apo kundërvajtëse, si dhe rrethanat familjare se i njëjti jeton i vetëm dhe se përmbushja e nevojave elementare si blerja e ushqimit, barnave, vizitave mjekësore do të vështirësohej nëse të njëjtit do t’i shqiptohej ky dënim, vlerësoi se edhe dënimi me kusht si dënim alternativ dhe tërheqja e vërejtjes dhe bërja me dije se nëse kryen vepra tjera penale të ngjashme apo vepra tjera penale brenda periudhës së verifikimit të caktuar nga gjykata, gjykata do të revokojë dënimin me kusht dhe do të urdhërojë ekzekutimin e dënimit të caktuar në dënimin me kusht, është dënim adekuat i cili do të ndikojë tek i pandehuri, që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit.

Vendimi mbi mundësinë e revokimit të dënimit me kusht është marrë në bazë të neneve 50 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale/paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 452 par. 1 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par. 3 nën-par. 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt juridiko civil është marrë në bazë të nenit 462 par. 2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.569/2023, Datë 21.05.2024

Procesmbajtëse
Erblina Aliu

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik SHEQIRI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.